



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2020:154211

Datë: 21.04.2021

Numri i dokumentit: 01717049

P.nr.1006/20

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren, Departamenti i përgjithshëm penal - gjyqtari Gani Kastrati, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Afërdita Kicaj, në lëndën penale kundër të akuzuarit U.Gj. nga Prizreni rr. për shkak të veprës penale, posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 269 parag.1. Kodit nr..06/L-074 Penal të Kosovës (KPRK)-së, I akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm Penal, PP.II.nr.1798-12/20 të datës 10.11.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në praninë e Prokurorit të Shtetit Naim Gashi, të akuzuarit U.Gj. me datë 13.04.2021 mori dhe shpalli, ndërsa përpiloi me datën 20.04.2021 këtë:

AKT GJYKIM

I akuzuari:

U.GJ. nga i ati H. dhe e ëma S. me mbiemër të vajzërisë S. i lindur me datë në fshatin tani me banim në rrugën ka të kryer shkollën fillore, i pa martuar, me profesion, furrtar, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal të letërnjoftimit

ËSHTË FAJTOR

Se me datë 31.08.2020, rrethe orës 18.55 në rrugën në Prizren, i pandehuri U.Gj. posedon pa autorizim narkotik të dyshuar e llojit marihuanë, ashtu që policia gjatë patrollimit, ndal të pandehurin dhe gjatë kontrollit tek i njëjti në xhepin e majtë është gjetur një foli alumini të mbushur me substancë të dyshuar për narkotikë e cila pas ekzaminimit ka rezultuar se është e llojit kanabis (marihuan) që përmban Tetrahidrokanabinol (THC) me peshë totale 0.73 plus 0.0001 gram.

Kështu ka kryer veprën penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 269 (par.1) i 1 të Kodit nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së).

Andaj gjykata në kuptim të nenit 4, 7, 8, 9, 17, 38, 39, 40, 43, 46, 47, 48, 69, 70, 71. par.1., nën par.1.2., neni 49. par.1. nën par.1.1. të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së:

Të akuzuarit U.Xh.

DËNIMIN ME GJOBË

Në shumën prej **200 € (dyqind) euro**, për veprën penale si në dispozitiv të aktgjykimi të cilin dënim me gjobë, në bazë të nenit 43. par. 2. të KPRK-së, i akuzuari është i obliguar ta paguajë në afat prej 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në qoftë se i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë në mënyrën e lartcekur, atëherë mundësia e pagesës së dënimit me gjobë me këste do të revokohet.

Nëse i akuzuari nuk mund apo nuk dëshiron ta paguajë dënimin me gjobë në shumë prej 200 € (dyqind) euro, atëherë gjykata konform nenit 43 par. 3 të KPRK-së, dënimin me gjobë, do t'ia zëvendësoj me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 € llogaritet 1 (një) ditë burgim, gjithsej 10 ditë burgim.

DËNIMIN ME KUSHT

Duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

I akuzuarit në kuptim të nenit 269. para.3. të KPRK-së i konfiskohet substanca narkotike e llojit kanabis (marihuan) që përmban Tetrahidrokanabinol (THC) me peshë totale 0.73 plus 0.0001 gram.

I akuzuari U.Xh. obligohet që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 euro, dhe për kompensimin e viktimave të krimit duhet të paguaj shumën prej 30 euro, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kërcënimin e përmbarimit ligjor.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Prizren, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP.II.nr.1798-12/20 të datës 10.11.2020, kundër të akuzuarit U.Gj. nga Prizreni rr. për shkak të veprës penale, posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 269. par.1. Kodit nr..06/L-074 Penal të Kosovës (KPRK)-së.

Pas leximit të aktakuzës, i akuzuari ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës së lartcekur, e ndien veten fajtor, dhe është i penduar për atë që ka ndodhur.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale, ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar më datë 13.04.2021, në prezencën e palëve, është lexuar aktakuza nga prokurori i shtetit në të cilin i akuzuari U.Gj. ka pranuar vullnetarisht fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës së lartcekur, është i penduar për atë se çka ka

ndodhur, dhe nga momenti kur jam hasur nga policia nuk jam përdorues i kësaj substance, kam gabuar, nuk kam ditur se është e ndaluar, jam i pa punë, i gjendjes së varfër materiale, mbajtës i vetëm i familjes, premtori dhe zotohet se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla kundërligjore, e lus gjykatën që të më shqiptoj një dënim më të butë,

Prokurori i shtetit nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, me qenëse i njëjti me pranimin e fajësisë sa i përket veprës penale e ka bërë vullnetarisht, që është në pajtim me nenin 248 të KPP-së.

Bazuar në pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit U.Gj. gjykata nuk është lëshuar në procedimin e provave.

Gjykata në shqyrtim gjyqësor nga pranimi i fajësisë nga i akuzuari dhe provave materiale në shkresat e lëndës, ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari U.Gj. me datë 31.08.2020, rreth orës 18.55 në rrugën në Prizren, i pandehuri U.Gj. posedon pa autorizim narkotik të dyshuar e llojit marihuanë, ashtu që policia gjatë patrollimit, ndal të pandehurin dhe gjatë kontrollit tek i njëjti në xhepin e majtë është gjetur një foli alumini të mbushur me substancë të dyshuar për narkotikë e cila pas ekzaminimit ka rezultuar se është e llojit kanabis (marihuan) që përmban Tetrahidrokanabinol (THC) me peshë totale 0.73 plus 0.0001 gram.

Kështu ka kryer veprën penale posdimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 269 (par.1) i 1 të Kodit nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së).

Gjykata, gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në seancën e shqyrtimit fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, andaj edhe gjykata nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare, gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme sipas nenit 257 të KPPRK-së.

Gjithashtu, gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Kësisoj, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 lidhur me nenin 326 të KPPRK-së, dhe se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 269 paragraf 1 Kodit nr.06/L-074 Penal të Kosovës (KPRK)-së, dhe për këtë gjykata ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe t'i shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penalo-juridike

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së,

të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Prej rrethanave lehtësuese, gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pendimin për rastin e ndodhur, për herë të parë bie ndesh me ligjin dhe premtimin se asnjëherë nuk do të kryej vepra penale. Andaj, duke mos gjetur ndonjë rrethanë të veçantë rënduese, gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij, ashtu që në të ardhmen të akuzuarin do ta parandalojë nga kryerja e veprave penale dhe se ky lloj i dënimit, sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i ka i akuzuari, dhe në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale u mor në kuptim të nenit 450. dhe 453. par. 1. të KPPRK-së.

Të akuzuarit i në kuptim të nenit 269. paragrafi 3. të KPRK-së i konfiskohet substanca narkotike llojit kanabis (marihuan) që përmban Tetrahidrokanabinol (THC) me peshë totale 0.73 plus 0.0001 gram.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë në kuptim të nenit 39. par. 3. pika 1. të Ligjit nr.05/L-036.

Nga të cekurat si më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2020:154211, 13.04.2021

G j y q t a r i

Gani Kastrati

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.